



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KAMËZ

Nr ____ Prot

Kamëz, më ____ . ____ . 2017

FORMULAR I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Bashkia Kamëz, **Adresa:** Bulevardi "BLU" Nr.492, Kamëz.

Për: Operatori ekonomik "**KTHELLA**" shpk me adrese : Rreshen, rruga "Shen Vinçenzo De Paolo" Perballe Varrezave te Qytetit.

Procedura e prokurimit: "**e hapur**". me mjete elektronike.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Rikualifikim Urbani Bllokut Babru Qender +Blloku poshte Alpetit Babrru**".

Kohëzgjatja e kontrates: **210 (dyqind e dhjetë) dite pune** nga data e lidhjes së kontratës
Fondi limit: **114.382.077**(njëqind e katërmbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e dymijë e shtatëdhjetë e shtatë) **leke pa tvsh.**

Burimi i financimit: **T'ardhurat e Bashkisë.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **01.03.2017 ora 10.00**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike
[Data] [Numri ____].

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "**KTHELLA**" sh.p.k, është paraqitur me vlerë të ofertës **111.867.692**lekë (pa TVSh) dhe **134.241.230** lekë (me TVSh).

2. Operatori ekonomik "**Ndregjoni**" sh.p.k, është paraqitur me vlerë të ofertës **113.881.234** lekë (pa TVSh) dhe **136.657.480** lekë (me TVSh).

3. Operatori ekonomik "**Nika**" sh.p.k, është paraqitur me vlerë të ofertës **92.370.666** lekë (pa TVSh) dhe **110.844.799** lekë (me TVSh).

4. Bashkimi I operatoreve ekonomik "**Sark shpk & Alba Konstruksion**" shpk, është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë të ofertës **89.233.807**lekë (pa TVSh) dhe **107.080.568** lekë (me TVSh).

5. Bashkimi I operatoreve ekonomik "**Alko-impex**" shpk & "**Ndreka**" shpk, është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë të ofertës **109.890.042** lekë (pa TVSh) dhe **131.868.050** lekë (me TVSh).

6. Bashkimi I operatoreve ekonomik "**Kacdedja**" shpk & "**Cara**" shpk & "**Agri Konstruksion**"shpk, është paraqitur me ofertën ekonomike me vlerë të ofertës **103.058.365**lekë (pa TVSh) dhe **123.670.038** lekë (me TVSh).

Ofertues të skualifikuar janë:

➤ **Operatori ekonomik "Ndregjoni" sh.p.k,** nuk plotëson këto kërkesa:

1. I mungojne kategorite e licenses profesionale
2. Nuk ka paraqitur makineri/pajisjet e kerkuara ne DST

➤ **Operatori ekonomik "Nika" sh.p.k,** nuk plotëson këto kërkesa:

1. Nuk ka paraqitur makinerite e kerkuara sipas DST-se

➤ **Bashkimi I operatoreve ekonomik "Sark shpk & Alba Konstruksion" shpk,** nuk plotëson këto kërkesa:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik SARK SHPK & ALBA KONSTRUKSION SHPK (asnjeri prej anetareve te ketij bashkimi operatoresh) nuk plotesojne piken NP – 10 Klasifikimi B ne Licencen e shoqërisë qe eshte kerkuar ne Dokumentat e Tenderit (DT).
2. Mungon sigurimi i ofertes.
3. Oferta dhe preventivi i paraqitur nga ky bashkim operatoresh ekonomike nuk eshte ai I hedhur ne www.app.gov.al dhe konkretisht ne kategorie VI. Kanalizim i ujrave te shiut jane shtuar shume zera te paqena dhe kategoria VII. Punime Elektrike dhe telefonike mungon fare keto gabime e bejne te pavlefshme kete oferte.
4. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj.... *“Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”* theksojme se tenderi eshte zhvilluar me date 01.03.2017 dhe ne kete date muaji janar 2017 ka qene I maturuar dhe operatoret pjesemarres ne kete procedure prokurimi duhet te paraqisnin vertetimin ku te perfshihej edhe ky muaj. Per kete ALBA KONSTRUKSION SHPK ka paraqitur vertetim debie nr. 778 prot. date 31.01.2017 ku ky vertetim nuk e ka te perfshier shlyerjen e energjise te muajit janar 2017 ne kundershtrim me kriterin e mesiperm te kerkuar ne dokumentat e tenderit (DT).
5. Ne kontraten e bashkepunimit nr. 467 rep. nr. 128 kol. date 28.02.2017 mes shoqerive SARK SHPK & ALBA KONSTRUKSION SHPK ndarja e punimeve eshte bere ne masen 77% per SARK SHPK dhe 23% per ALBA KONSTRUKSION SHPK per sa me siper SARK SHPK nuk ploteson numrin e punonjesve ne raport me % qe ka marre persiper ne kontraten e sipercituar konkretisht duhet te kishte 77 punonjes dhe ka vetem 72 (bazuar ne listepagesen e tij). Shoqeria SARK SHPK nuk ploteson xhiron per vitet 2013, 2014, 2015 ne raport me % qe ka marre persiper ne kontraten e sipercituar konkretisht duhet te kishte xhiro 88 074 199 leke dhe ne fakt ne asnje nga vitet e kerkuara (2013, 2014 dhe 2015) nuk e ploteson kete shume xhiroje.
6. Shoqeria SARK SHPK nuk ploteson kriterin *“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.(57.191.039) leke pa tvsh”* asnje nga kontrat e paraqitura nuk e ploteson kete kriter. Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike kete kriter duhet ta plotesoje te plote shoqeria me % me te larte ne kontraten e bashkepunimit. Madje Sark Shpk edhe si shume kontratash nuk e ploteson kriterin *“Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”* me te gjitha kontratat SARK SHPK ka nje shume prej me pak se 62 milion lek me tvsh.
7. Shoqeria SARK SHPK nuk ka paraqitur vertetim numri punonjesish, urdherpagesat e sigurimeve dhe TAP si dhe Listepagesen e konfirmuar nga Drejtoria Vendore e Punesimit permuajin Janar 2017 te kerkuar ne DT.
8. Shoqeria SARK SHPK nuk ka paraqitur vertetim taksa vendore per vitet 2015 dhe 2016.
9. Shoqeria ALBA KONSTRUKSION SHPK nuk ka paraqitur vertetim taksa vendore per vitet 2014, 2015 dhe 2016 ne bashkite Kavaje dhe Kamez ku ne baze te QKB (QKR) rezulton te kete ushtruar aktivitet privat ne keto vite si dhe nuk ka paraqitur vertetim per bashkine Rreshen (Mirdite) per vitin 2014.

10. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj.... “*Shoqerite pjesemarrrese ne kete procedure prokurimi duhet te jene te pajisura me:*
- *Leje mjedisi e tipit C e leshuar nga QKB me kod III.1.A sebashku me akt miratimin e saj dhe e vlefshme ne daten e procedures se prokurimit*
 - *Licence e leshuar nga QKB me kod III.2.B sebashku me akt miratimin e saj e vlefshme ne daten e procedures se prokurimit.*
- Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter”* Shoqeria SARK SHPK dhe shoqeria ALBA KONSTRUKSION SHPK nuk i kane paraqitur as lejen e as licencen per te plotesuar kete kriter, nderkohe qe ne DT eshte kerkuar *Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter.*
11. Shoqeria SARK SHPK nuk ka paraqitur vertetim banke ne masen e kerkuar ne DT
12. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... “*Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001-2008 , ISO 14001-2004 , PAS 99: 2012, SA 8000 -2014, ISO 50001 -2011, ISO/IEC 27001 -2013, OHSAS 18001-2007; ISO 28001:2007 per prodhimin (ose kontrate furnizimi) e materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku minimalisht te perfshihen:*
- *Bordura – Pllaka- Elemente te parafabrikuara te betoneve- Llaçra”* bashkimi i operatoreve ekonomik SARK SHPK & ALBA KONSTRUKSION SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri.
13. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... “*Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 14001-2004; ISO/IEC 27001 – 2013 dhe ISO 28001:2007 per punime te inxhinierise mjedisore (punime gjelberimi)”* bashkimi i operatoreve ekonomik SARK SHPK & ALBA KONSTRUKSION SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri edhe ne fusheveprimin e certifikatave iso te paraqitura nuk permbahen *punime te inxhinierise mjedisore (punime gjelberimi).*
14. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... “*Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001-2008 , ISO 14001-2004 , PAS 99: 2012 per prodhimin (ose kontrate furnizimi) e materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku minimalisht te perfshihen: Inerte, Betone”* bashkimi i operatoreve ekonomik SARK SHPK & ALBA KONSTRUKSION SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri edhe ne fusheveprimin e certifikatave iso te paraqitura nuk permbahen prodhim Inerte e Betone.
15. Shoqeria ALBA KONSTRUKSION SHPK dhe SARK SHPK nuk kane paraqitur ditarin (inventarin) e mjeteve kryesore te konfirmuar nga Dega e Tatim Taksave per vitet 2013-2014-2015, ne kundërshtim me kerkesat e DT. Shoqeria SARK SHPK nuk ka paraqitur as auditimin e ekspertit kontabel bilancet e ketyre viteve.
16. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... “*Shoqeria duhet te paraqesë Certifikata per objektin e prokurimit:*
- *ISO 9001-2008 (e vlefshme)*
 - *OHSAS 18001-2007 (e vlefshme)*
 - *ISO 14001-2004 (e vlefshme)*
 - *ISO 39001-2012 (e vlefshme)*
 - *PAS 99-2012 (e vlefshme)*
 - *EN ISO 3834-2:2005 (e vlefshme)*
 - *ISO/IEC 27001 -2013 (e vlefshme)*
 - *ISO 50001 -2011 (e vlefshme)*

- SA 8000 -2014 (e vlefshme)
 - ISO 28001:2007 (e vlefshme)
- Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata”*

Kriterin e mesiperm te kerkuar ne DT nuk e ploteson shoqeria SARK SHPK pasi nuk ka paraqitur EN ISO 3834-2:2005, ISO/IEC 27001 -2013, SA 8000 -2014 dhe ISO 28001:2007 dhe ISO-t e paraqitura nuk jane ne gjuhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit (Shqip).

17. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj... *“Shoqeria te kete minimalisht 27 (njezet e shtate) punonjes te kualifikuar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik...”* per keto punonjes jane paraqitur deshmi Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik por nuk jane paraqitur Kontrate noteriale e punes dhe Librezat e punes.

18. Mungonjne Autovinç me krah 26m dhe me grafikun e kapacitetit dhe foto, Fabrike asfalti (ose kontrate furnizimi).

➤ Bashkimi I operatoreve ekonomik “Alko-impex” shpk & “Ndrekaj” shpk, nuk plotëson këto kërkesa:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik ALKO-IMPEX SHPK & NDREKAJ SHPK (asnjeri prej anetareve te ketij bashkimi operatoresh) nuk plotesojne piken NS – 8 Klasifikimi D ne Liçencen e shoqërisë qe eshte kerkuar ne Dokumentat e Tenderit (DT).

2. Kontrata per bashkimin e perkohshem te shoqerive ALKO-IMPEX SHPK & NDREKAJ SHPK me nr. 1812 rep. dhe nr. 1400 kol. date 28.02.2017 eshte e pavlefshme pasi nuk eshte nenshkruar (ne asnje flete te saj) nga noteria prandaj kjo kontrate nuk merret parasyshe.

3. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... *“Shoqeria duhet te paraqesë Certifikata per objektin e prokurimit:*

- ISO 9001-2008 (e vlefshme)
- OHSAS 18001-2007(e vlefshme)
- ISO 14001-2004 (e vlefshme)
- ISO 39001-2012 (e vlefshme)
- PAS 99-2012 (e vlefshme)
- EN ISO 3834-2:2005 (e vlefshme)
- ISO/IEC 27001 -2013 (e vlefshme)
- ISO 50001 -2011 (e vlefshme)
- SA 8000 -2014 (e vlefshme)
- ISO 28001:2007 (e vlefshme)

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata”

Kriterin e mesiperm te kerkuar ne DT nuk e ploteson shoqeria NDREKAJ SHPK pasi nuk ka paraqitur ISO/IEC 27001 -2013, SA 8000 -2014 dhe ISO 28001:2007 dhe ISO-t e paraqitura nuk jane asnjera ne gjuhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit (Shqip). Kriterin e mesiperm te kerkuar ne DT nuk e ploteson shoqeria ALKO-IMPEX SHPK pasi nuk ka paraqitur ISO 28001:2007.

4. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... *“Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001-2008 , ISO 14001-2004 , PAS 99: 2012, SA 8000 -2014, ISO 50001 -2011, ISO/IEC 27001 -2013, OHSAS 18001-2007; ISO 28001:2007 per prodhimin (ose kontrate furnizimi) e materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku mimimalisht te perfshihen:*

- *Bordura – Pllaka- Elemente te parafabrikuara te betoneve- Llaçra*”bashkimi i operatoreve ekonomik ALKO-IMPEX SHPK & NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri (ISO ISO 28001:2007mungon fare).
5. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... “*Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 14001-2004; ISO/IEC 27001 – 2013 dhe ISO 28001:2007 per punime te inxhinierise mjedisore (punime gjelberimi)*”bashkimi i operatoreve ekonomik ALKO-IMPEX SHPK & NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri(ISO ISO 28001:2007mungon fare).
 6. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj.... “*Shoqerite pjesemarrrese ne kete procedure prokurimi duhet te jene te pajisura me:*
 - *Leje mjedisi e tipit C e leshuar nga QKB me kod III.1.A sebashku me akt miratimin e saj dhe e vlefshme ne daten e procedures se prokurimit*
 - *Licence e leshuar nga QKB me kod III.2.B sebashku me akt miratimin e saj e vlefshme ne daten e procedures se prokurimit.**Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter*” Shoqeria NDREKAJ SHPK nuk i ka paraqitur as lejen e as licencen per te plotesuar kete kriter, nderkohe qe ne DT eshte kerkuar*Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter.*
 7. Shoqeria ALKO-IMPEX SHPK nuk ka paraqitur ditarin (inventarin) e mjeteve kryesorete konfirmuar nga Dega e Tatim Taksave per vitet 2013-2014-2015, ne kundershtim me kerkesat e DT.
 8. Shoqeria ALKO-IMPEX SHPK nuk e ka paraqitur listepagesen e muajit janar 2017 te konfirmuar nga Administrata Tatimore sikurse ishte kerkuar ne DT dhe Urdher pagese për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetesore dhe Urdher pagese per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi (TAP) te vulosura nga banka per muajin janar 2017 eshte paraqitur fotokopje ne kundershtim me DT si mungojneFaturat bankare te pageses se sigurimeve dhe tap per janar 2017 te kerkuara ne DT. Kjo shoqeri nuk e ka paraqitur dokumentin e kerkuar ne DT citoj ... “*Lista e punonjesve per muajin janar viti 2017 e çertifikuar nga Drejtoria Vendore e Punesimit ku per secilin nga punonjesit te jene te specifikuara Emri Mbiemri, Datelindja, Adresa banimit, numri regjistrimit themeltar, profesioni, paga, arsimi, data e punesimit ne subjekt*”.Ne DT eshte kerkuar citoj “*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*”
 9. Shoqeria NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur Vërtetim të lëshuar Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te muajit Janar 2017 te kerkuar ne DT.
 10. Shoqeria NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur Listepagesen e konfirmuar nga Administrata Tatimore per muajin Janar 2017 te kerkuar ne DT.
 11. Shoqeria NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur *Urdher pagese për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetesore dhe Urdher pagese per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi (TAP) te vulosura ngabanka dhe te shoqeruara me Faturat bankare te pageses se tyre* per muajin Janar 2017 te kerkuar ne DT.
 12. Shoqeria NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur Listen e punonjesve per muajin janar viti 2017 e çertifikuar nga Drejtoria Vendore e Punesimit ku per secilin nga punonjesit te jene te specifikuara Emri Mbiemri, Datelindja, Adresa banimit, numri regjistrimit themeltar, profesioni, paga, arsimi, data e punesimit ne subjektper muajin Janar 2017 te kerkuar ne DT.
 13. Mungon arkitekti i kerkuar ne DT. Arkitekt Selver Beqiri nuk ka kontrate noteriale dhe as eshte lidhur me administratorin e firmes ALKO IMPEX SHPK dhe

nuk I referohet legjislacionit të RSH-se (kodi punes) kjo në kundërshtim me kërkesat në DT. Mungon deshmia IQT për të.

14. Mungon Inxhinieri ndertimit (profili infrastrukture transporti) I kërkuar në DT.
 15. Mungon i gjithë dokumentacioni i kërkuar në DT për 2 ekonomista.
 16. Shoqëria NDREKAJ SHPK nuk ka paraqitur ditarin (inventarin) e mjeteve kryesore të konfirmuar nga Dega e Tatimit Taksave për vitet 2013-2014-2015, në kundërshtim me kërkesat e DT.
 17. Shoqëria ALKO IMPEX SHPK nuk plotëson vlerën e xhiros për vitin 2013 sipas % së marrë për sipër për ekzekutim kontratë (90%) në kundërshtim me kërkesën në DT.
 18. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ALKO-IMPEX SHPK & NDREKAJ SHPK nuk plotëson makineritë e konkretisht Kamionat minimalisht 20 ton 4 cope, Kamionat minimalisht 12 ton 7 cope, Autobetonieret 3 cope, Autopompe betoni cope 1. Mjetet e paraqitura të Kosovës nga ALKO IMPEX SHPK nuk kanë kolaudimin dhe Deklaratën e kësaj shoqërie ku citon Certifikatën e kontrollit teknik nuk aplikohet është një deklaratë e rreme pasi ajo aplikohet dhe quhet Certifikatë mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit, mos hëdhja në sistem e kësaj certifikate e ka bërë të pamundur verifikimin e vlerësimit të tonazhit të kamioneve.
 19. Mungon sigurimi i ofertes.
 20. Për mjekët Sherif Fusha mungon kontrata notoriale dhe për mjekën Blerta Ndreka mungon CV-ja dokumenta të kërkuara në DT.
 21. Mungojnë leje qarkullimi, kolaudim, taksa vjetore, sigurim, certifikatë pronësie dhe grafiku i kapacitetit për Autovinç me krah 26m.
 22. Mungon Rimorkiatori me foto, Autobitumatrice me foto, Fabrikë asfalti (ose kontratë furnizimi), Rul 6-8ton.
 23. Në dokumentat e tenderit është kërkuar citoj... *“Shoqëria të ketë minimalisht 27 (nëzet e shtatë) punonjës të kualifikuar me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik...”* për këto punonjës janë paraqitur dëshmi Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik por nuk janë paraqitur Kontrata notoriale e punës, Kartë Identiteti, Libreza e punës. Shoqëria NDREKAJ SHPK nuk plotëson punimet e ngjashme. Punimi i paraqitur i mungon Certifikatën e marrjes në dorezim teperhershëm i kërkuar në DT.
- **Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk & “Cara” shpk & “Agri Konstrustion”shpk**, nuk plotëson këto kërkesa:
1. Në dokumentat e tenderit është kërkuar *“Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”* theksojmë se tenderi është zhvilluar me datë 01.03.2017 dhe në këtë datë muaji janar 2017 ka qenë i maturuar dhe operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqisnin vërtetimin ku të përfshihej edhe ky muaj. Për këtë AGRI KONSTRUSTION SHPK ka paraqitur vërtetim debie nr. 10667 prot. datë 28.12.2016 ku ky vërtetim nuk e ka të përfshirë shlyerjen e energjisë as të muajit janar 2017 dhe as të muajit dhjetor 2016 në kundërshtim me kriterin e mesipër të kërkuar në dokumentat e tenderit (DT). Shoqëria CARA SHPK ka paraqitur vërtetim debie nr. 44 prot. datë 02.02.2017 ku ky vërtetim nuk e ka të përfshirë shlyerjen e energjisë të muajit janar 2017 në kundërshtim me kriterin e mesipër të kërkuar në dokumentat e tenderit (DT).
 2. Në dokumentat e tenderit është kërkuar që *“Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën për objektin e prokurimit:*
 - *ISO 9001-2008 (e vlefshme)*
 - *OHSAS 18001-2007 (e vlefshme)*

- ISO 14001-2004 (e vlefshme)
- ISO 39001-2012 (e vlefshme)
- PAS 99-2012 (e vlefshme)
- EN ISO 3834-2:2005 (e vlefshme)
- ISO/IEC 27001 -2013 (e vlefshme)
- ISO 50001 -2011 (e vlefshme)
- SA 8000 -2014 (e vlefshme)
- ISO 28001:2007 (e vlefshme)

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata”

Kriterin e mesiperm te kerkuar ne DST nuk e ploteson shoqeria CARA SHPK pasi nuk ka paraqitur EN ISO 3834-2:2005, SA 8000 -2014 dhe ISO 28001:2007. Kriterin e mesiperm te kerkuar ne DST nuk e ploteson shoqeria AGRICULTURE SHPK pasi nuk ka paraqitur SA 8000 -2014 dhe ISO 28001:2007 dhe ISO-t e paraqitura nuk jane ne gjuhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit (Shqip). Kriterin e mesiperm te kerkuar ne DST nuk e ploteson shoqeria KACDEDJA SHPK pasi nuk ka paraqitur ISO 28001:2007 dhe ISO-t e paraqitura nuk jane te gjitha ne gjuhen e kerkuar ne dokumentat e tenderit (Shqip).

3. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar “*Shoqerite pjesemarrrese ne kete procedure prokurimi duhet te jene te pajisura me:*

- *Leje mjedisi e tipit C e leshuar nga QKB me kod III.1.A se bashku me akt miratimin e saj dhe e vlefshme ne daten e procedures se prokurimit*
- *Licence e leshuar nga QKB me kod III.2.B se bashku me akt miratimin e saj e vlefshme ne daten e procedures se prokurimit.*

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter” asnje nga shoqerite KACDEDJA SHPK & CARA SHPK & AGRICULTURE SHPK nuk i ka paraqitur as lejen e as licencen per te plotesuar kete kriter, nderkohe qe ne DT eshte kerkuar *Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter.*

4. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar “*Shoqeria, duhet te kete te punesuar 1 (nje) Mjek i cili duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise te muajit te fundit te kerkuar. Per te cilin te paraqiten:*

- *Kontrate noteriale e punes*
- *Diploma*
- *Liçense leshuar nga urdheri i mjekeve*
- *CV-te*
- *Libreza e punes*

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, secili anetar i grupit duhet te plotesoje kete kriter”

Shoqeria AGRICULTURE SHPK nuk e ploteson kete kriter pasi ne listepagesen e muajit janar 2017 nuk figuron mjek i siguruar.

5. Shoqeria AGRICULTURE SHPK nuk ka paraqitur deklaratën për disponimin e makinerive.

6. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar “*Lista e punonjesve per muajin janar viti 2017 e çertifikuar nga Drejtoria Vendore e Punesimit ku per secilin nga punonjesit te jene te specifikuara Emri Mbiemri, Datelindja, Adresa banimit, numri regjistrimit themeltar, profesioni, paga, arsimit, data e punesimit ne subjekt”* asnje nga shoqerite KACDEDJA SHPK & CARA SHPK & AGRICULTURE SHPK nuk e ka paraqitur kete document per te plotesuar kete kriter.

7. Shoqeria CARA SHPK nuk ka paraqitur listepagesen e muajit janar 2017 te konfirmuar nga Administrata Tatimore ne kundershtim me kerkesat ne DT.
8. Shoqeria AGRI CONSTRUCTION SHPK nuk ka paraqitur ditarin (inventarin) e mjeteve kryesorete konfirmuar nga Dega e Tatim Taksave ne kundershtim me kerkesat e DT per vitet 2013-2014-2015.
9. Nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2015 nga bashkia Durres pasi ne baze te QKB (QKR) rezulton se ka kryer aktivitet.
10. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar *“Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001-2008 , ISO 14001-2004 , PAS 99: 2012, SA 8000 -2014, ISO 50001 -2011, ISO/IEC 27001 -2013, OHSAS 18001-2007; ISO 28001:2007 per prodhimin (ose kontrate furnizimi) e materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku minimalisht te perfshihen:*
- Bordura – Pllaka- Elemente te parafabrikuara te betoneve- Llaçra” bashkimi i operatoreve ekonomik KACDEDJA SHPK & CARA SHPK & AGRI CONSTRUCTION SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri.
11. Ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar citoj ... *“Operatoret ekonomike duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 14001-2004; ISO/IEC 27001 – 2013 dhe ISO 28001:2007 per punime te inxhinierise mjedisore (punime gjelberimi)”* bashkimi i operatoreve ekonomik KACDEDJA SHPK & CARA SHPK & AGRI CONSTRUCTION SHPK nuk ka paraqitur dokumentacion per permbushjen e ketij kriteri edhe ne fusheveprimin e certifikatave iso te paraqitura nuk permbahen *punime te inxhinierise mjedisore (punime gjelberimi).*
12. Per shoqerine KACDEDJA SHPK mungon vertetimi I xhiros 2013 I kerkuar ne DT.
13. Mungojne IQT-te per: 3 specialista ndertimi, 3 karpentier dhe 1 hekurkthyes si dhe per punonjesit e paraqitur me IQT mungojne librezat e punes.
14. Bashkimi I operatoreve ekonomike KACDEDJA SHPK & CARA SHPK & AGRI CONSTRUCTION SHPK nuk ploteson makinerite e kerkuara ne DT dhe konkretisht mungojne 3 Kamiona minimalisht 12 ton (pasi mjetit me targa AA263FK I mungon siguracioni; mjetit me targe TR5106R I mungon leja e transportit; mjetit me targe AA226NJ I mungon siguracioni). Mungon Rimorkiator me foto (pasi rimorkiatorit me targa AA348AG I mungojne siguracioni, kolaudimi, taksat dhe leja e transportit). Mungon Autovinç me krah 26m dhe me grafikun e kapacitetit dhe foto (kamioni me vinc nuk eshte autovinc dhe autovincit me targa AA206NJ I mungojne kolaudimi, siguracioni dhe taksat). Mungon Rul ngjeshes 6-8 ton.
15. Mungon sigurimi i ofertes i kerkuar ne DT.
16. Mungon dokumentacioni per 2 ekonomistat e kerkuar ne DT.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik **KTHELLA** sh.p.k, me adrese : Rreshen, rruga “Shen Vinçenzo De Paolo” Perballe Varrezave te Qytetit. është paraqitur me vlerë të ofertës **111.867.692**lekë (pa TVSh) dhe **134.241.230** lekë (me TVSh), e vleresuar si oferta me e sukseshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kamëz (Drejtorisë Juridike), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në Rregullat e Prokurimit Publik, brënda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi dhe jo me vonë se 60 ditë për lidhjen e kontratës, duke sjellë dhe dokumentet e paraqitura në sistem (origjinale ose fotokopje të noterizuara).

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura do të anulohet për mosplotësim të numrit minimal të konkurentëve në bazë të ligjit për prokurimet publike Nr.9643 datë 20.11.2006, të ndryshuar

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **08.03.2017**

Ankesa: ka ose jo **Jo**

Xhelal MZIU

KRYETAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR



